



Bashkia Korçë



Lidhur sot, më datë 27/2 2015

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

BASHKIA KORCE

dhe

FONDACIONIT “MISIONI EMANUEL”

Kjo është një marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projekteve : “Qendër komunitare për moshën e tretë” dhe “Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë” midis Bashkisë Korçë dhe Fondacionit “ Misioni Emanuel”.

Duke shprehur reciprokisht vullnetin dhe konform legjislacionit shqiptar në fuqi palët bien dakort për sa më poshtë vijon:

NENI 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet me qëllim zbatimin e projekteve: “Qendër komunitare për moshën e tretë” dhe “Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë”

NENI 2

Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi me Fondacionin Misioni Emanuel për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe ofrimin e shërbimeve psiko–sociale, mjekësore, kulturore dhe argëtuese për të gjithë të moshuarit, të cilët frekuentojnë këto qendra, të cilat funksionojnë në kuadër të projektit “Qender komunitare për moshën e tretë”.

Il Baraku

Gjithashtu, kjo marrëveshje në kuadër të projektit “Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë” ka për qëllim të përmirësojë mirëqenien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë për të shmangur efektet e izolimit social dhe problematikat e ndryshme me të cilat përballet komuniteti Rom dhe Egjiptian në qytetin e Korçës.

NENI 3

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë , Ligjit 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar , ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Bashkiak Korçë Nr. 4 datë 28.01.2015 “Për fillimin e bashkëpunimit 3 vjeçar midis Bashkisë Korçë dhe Fondacionit “Misioni Emanuel” për zbatimin e projekteve “Qendër komunitare për moshën e trete” dhe “Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë

NENI 4

Detyrimet e Bashkisë Korçë

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje Bashkia Korçë merr përsiper:

1. Të punojë së bashku me Fondacionin “Misioni Emanuel” për realizimin e projekteve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.
 2. Të sigurojë 4 ambjente të përshtatshme për realizimin e projektit “Qendër komunitare për moshën e trete” dhe 3 ambjente për realizimin e projektit “Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë”. *(2 prej të cilave janë prone e Bashkisë Korçë)*
- Mënyra dhe procedura ligjore që do të ndiqet për përzgjedhjen e 5 (pese) ambjenteve të tjera do të kryhet nga Bashkia Korçë.
3. Të paguajë faturat mujore të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm për të gjitha qendrat (respektivisht 7 qendra). Në çdo rast shuma që do të paguajë Bashkia nuk mund të jetë më e madhe se parashikimi i bërë në buxhetin e Bashkisë Korçë.
 4. Ti dorëzojë Fondacionit “Misioni Emanuel” një raport financiar vjetor në lidhje me shpenzimet e kryera për zbatimin e projekteve : “Qendër komunitare për moshën e trete” dhe “Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë”.



M. Baraku

NENI 5

Detyrimet e Fondacionit "Misioni Emanuel"

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje Fondacioni "Misioni Emanuel " është përgjegjës:

1. Të punojë së bashku me Bashkinë Korçë për realizimin e projekteve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.
2. Të zbatojë projektet e përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.
3. Të organizojë punën në "Qendër komunitare për moshën e tretë" dhe "Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i fëmijeve Rome dhe Egjiptiane " duke ofruar shërbimet e përmendura në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.
4. Të marrë përsipër të gjitha shpenzimet e parashikuara në buxhetin e aprovuar për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, me përjashtim të shpenzimeve të marra përsipër nga Bashkia Korçë, bazuar në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje.
5. Ti dorëzojë Bashkisë Korçë një raport narrativ mujor në lidhje me aktivitetet e kryera për zbatimin e projekteve : "Qendër komunitare për moshën e tretë" dhe "Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë".
6. Ti dorëzojë Fondacionit Dorcas Albania raporte narrative dhe financiare sipas formateve dhe afateve të përcaktuara, për projektet : "Qendër komunitare për moshën e tretë" dhe "Qendra ditore për fëmijë, Fuqizimi i Fëmijeve Romë dhe Egjiptianë".

NENI 6

Afati i hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët.


NENI 7

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje i shtrin efektet e saj deri në 31 dhjetor 2017.

NENI 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve



14 Baraku

Për mosmarrëveshjet e ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët zotohen t'i zgjidhin me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

NENI 10


Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje quhet e vlefshme vetem pasi të jetë nënshkruar nga të treja palët.
2. Kjo marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje një për secilën palë
3. Kësaj marrëveshje i bashkëngjitet : Paketa e punes (e miratuar) si edhe buxheti i aprovuar për vitin 2015, (buxhetet e dy viteve të ardhshme do të bashkëngjiten në momentin që ato behen të vlefshme)

PËR BASHKINË KORÇË

KRYETARI

z. Sotirag FILO



PER "MISIONIN EMANUEL"

Drejtore ekzekutive

znj. Mariela BARAKU

A handwritten signature in black ink, which appears to read "M. Baraku", is written over a faint circular stamp.